

MBYLLËM NJË VIT SHUMË POZITIV, BURIMET NJERËZORE JANË SFIDA E MADHE PËR BANKAT DHE EKONOMINË

Viti 2022 ishte shumë pozitiv për Union Bank, me tregues veçanërisht të lartë të marzhit neto nga interesat dhe kthimi i kapitalit. Flutura Veipi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e Union Bank, thotë se ecuria e mirë e Union Bank dhe e sektorit bankar në përgjithësi, u mbështet në gjendjen e lartë të likuiditetit në treg dhe në vazhdimësinë e rritjes së kreditimit, pavarësisht shqetësimeve për rritjen e kostove të financimit në të ardhmen. Sipas saj, bankat nuk e përcollën rritjen e normave referuese të interesit në çmimin e kredive të reja dhe kjo ndikoi shumë në ruajtjen e ritmeve të kënaqshme të huadhënies.

Duke parë nga e ardhmja, znj. Veipi mendon se sfida më e madhe e sektorit bankar dhe e ekonomisë është problemi i burimeve njerëzore dhe qëndrueshmëria e kërkesës konsumatore, që buron nga demografia. Sipas saj, bankat po ndjekin politika gjithnjë e më të shëndetshme të burimeve njerëzore, por largimi i profesionistëve nuk është një çështje që lidhet vetëm me punën, por me kushtet dhe perspektivat e përgjithshme ekonomike dhe sociale.

Znj. Veipi thotë se bankat do të gjejnë mënyrat për të mos cenuar vijueshmërinë e aktivitetit, duke përdorur më shumë marrjen e shërbimeve nga kontraktorë të jashtëm (outsourcing) dhe duke zgjeruar depërtimin e teknologjisë në ofrimin e shërbimeve. Në periudhën afatshkurtër, sipas saj, sektori do të ketë kostot e një zhvillimi më të ngadaltë nga mungesa e stabilitetit të burimeve njerëzore.

Si do ta vlerësonit ecurinë e Union Bank vitin e kaluar? Cilat ishin zhvillimet më të rëndësishme në bankën tuaj dhe më gjerë në aktivitetin e sistemit bankar shqiptar?

Rezultatet e vitit 2022 ishin shumë pozitive për ne dhe për gjithë sektorin bankar, por nuk mund të them se ishin surprizë. Këto rezultate



**FLUTURA
VEIPI**

**Drejtore e Përgjithshme
Ekzekutive e Union Bank**

pozitive ishin të pritshme, si rrjedhojë e shtyrjes së investimeve dhe shpenzimeve konsumatore nga viti 2021, por edhe prej inflacionit. Në gjysmën e parë të vitit, pati rritje të lartë të kreditimit, ndikuar nga rritja e çmimeve, pasiguria e krijuar nga lufta në Ukrainë, thyerjet e zinxhirit të shpërndarjes, të gjithë faktorë që shtynë bizneset drejt kredimarrjes në vlera të mëdha.

Duke pasur një nivel kaq të lartë likuiditeti në treg, kreditimi vazhdoi të rritej, pavarësisht frikës nga rritja e kostove të financimit. Kjo ndodhi sepse sektori bankar nuk e përcollti rritjen e normave referuese të interesit në kreditë e reja. Pati një efekt të rritjes në kreditë ekzistuese me normë të ndryshueshme interesi, për shkak të reflektimit të rritjes së yield-eve apo Euriborit dhe kjo solli ndikim pozitiv në marzhet e interesit të sektorit.

Rritja e interesave nuk u reflektua shumë në normat e interesit për kreditë e reja, për disa arsye: E para,

jemi një treg shumë likuid; e dyta, tregu është i vogël me tendencat demografike në tkurrje të vazhdueshme. Kjo do të thotë se numri i klientëve potencialë është i kufizuar dhe ka një konkurrencë të fortë për ta. Vlera e marrjes së një klient të ri është gjithmonë e lartë. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se ka pasur banka të mëdha që kanë ndjekur një strategji të zhvendosjes së investimeve nga instrumentet financiare te kreditë. Për të hyrë në tregun e kredisë, këto banka kanë ofruar kushte shumë tërheqëse, norma të ulëta interesi. Kur ti investon për të krijuar portofol, justifikohet një normë e ulët interesi, sepse zakonisht bëhet fjalë edhe për kredi individuale afatgjata, që për hir të maturitetit të gjatë, sjellin mundësinë për të rikuperuar të ardhurat me kalimin e viteve. Duke e përmbledhur këtë situatë nuk e ndiem në kërkesë, në likuiditet dhe në financë, ndaj viti 2022 nuk krijoi asnjë problem.

Në një mjedis të tillë, edhe Union Bank e mbylli vitin me rezultate pozitive, me tregues veçanërisht të lartë të marzhit neto, nga interesat dhe kthimi i kapitalit.

Vitin e kaluar, ekonomia u përball me inflacionin më të lartë në dy dekada dhe me rritje të shpejtë të normave të interesit. Si u reflektuan këto zhvillime në ecurinë e sektorit bankar?

Viti 2022 konfirmoi soliditetin e sektorit bankar. Megjithatë çmimi i kredisë dhe rreziku kreditor mund të rritet, mendoj se situata do të jetë e menaxhueshme, sepse është e pritshme që inflacioni gradualisht të stabilizohet dhe ekonomia t'u kthehet ritmeve normale të rritjes. Sigurisht, ka pasur segmente që janë prekur nga inflacioni. Është prekur segmenti më të ardhura të ulëta, i cili, megjithatë, nuk ka peshë shumë të rëndësishme në volumet e kredisë bankare. Inflacioni në ekonominë tonë ishte më i kontrolluar krahasuar me ekonominë e tjera europiane, kryesisht



♦♦ falë subvencionimit të çmimit të energjisë elektrike.

Në fund të fundit, në një ekonomi kaq likuide sa e jona, alternativat e investimit janë të kufizuara. Pasuritë e paluajtshme janë alternativë kryesore për të investuar likuiditetin e tepërt dhe ky sektor e mbajti lart, si tregun e pronave, edhe kreditimin, në një marrëdhënie të ndërsjellë.

Për sa i përket vitit 2023, nuk priten efekte dramatike në sektorin bankar. Të dhënat e PBB-së treguan rritje ekonomike më të mirë se parashikimet për 2023. Sipas Bankës së Shqipërisë, në harkun e dy viteve të ardhshme, inflacioni pritet të ulet gradualisht pranë objektivit. Është e pritshme që brenda dy vitesh, presionet inflacioniste do të ulen, po ashtu edhe efektet e tyre në rritjen ekonomike. Inflacioni ka ngadalësuar rritjen e kursimeve në Lek, ndërkohë, depozitat në Euro kanë pasur rritje. Kjo mund të ndikojë edhe në strukturën e kredisë, duke e orientuar më shumë drejt valutës. Ne në Union Bank kemi kryer vazhdimisht stress-teste dhe projektionet tona tregojnë se, efektet e inflacionit në cilësinë e portofolit të kredisë do të jenë shumë të vogla, më pak se 1 pikë përqindje. Kjo na jep konfortin për të mos qenë të shtrënguar në kreditim. Edhe kërkesa nuk po jep shenja shqetësuese ngadalësimi. Ndaj, vitin

2023 e shohim si të qëndrueshëm, me tendenca të ngjashme me dy vitet e mëparshme.

Cilat do të jenë objektivat tuaja kryesore në vitin 2023 dhe cilat prisni të jenë sfidat kryesore për biznesin e bankave këtë vit?

Sfida më e madhe e sektorit bankar dhe e gjithë ekonomisë është problemi i burimeve njerëzore dhe qëndrueshmëria e kërkesës konsumatore, që buron nga demografia. Në kohët e sotme është faktike që emigracioni ka arritur në nivelin e profesionistëve. Kjo paraqet një sfidë për të arritur atë rritje cilësore të nivelit të burimeve njerëzore, për të cilën ka nevojë sektori bankar. Është një sfidë shumë e madhe dhe nuk është problem që mund ta adresojmë ne si bankë, apo qoftë sektori bankar në tërësi, sepse nuk është një çështje që lidhet vetëm me punën. Dilema e shumë njerëzve sot është të jetojnë apo të mos jetojnë në Shqipëri. Emigracioni nuk lidhet vetëm me marrëdhënien me punëdhënësin, me nivelin e pagës apo me mundësitë për të bërë karrierë; largimi ka të bëjë me mjedisin e përgjithshëm, çfarë i ofrohet individit në nivelin e sigurisë, atë të shërbimeve, të arsimit, të shëndetit, etj.

Ne po përballemi me largime të stafit edhe në nivel menaxherial dhe mendo-

jmë se kjo lidhet kryesisht me dëshirën për t'u siguruar një të ardhme më të mirë fëmijëve. Hapësirat që ka krijuar tregu i punës në Europë e favorizojnë këtë proces dhe e bëjnë më të lehtë që profesionistët të largohen. E vetmja gjë që mund të bëjmë është të ndjekim politika të shëndetshme të burimeve njerëzore, të ofrojmë paga më të mira, me aq mundësi sa kemi, përfitime, trajnime, etj.. Megjithatë, nuk besoj se kjo do të ndikojë në tendencën e largimit të profesionistëve, sepse, sikurse e përmenda, nuk është një çështje që lidhet me marrëdhënien e punës. Ajo lidhet me procese shumë të gjera, që kërkojnë kohë të gjatë, ndaj edhe jam pesimiste lidhur me mundësinë për ta frenuar largimin e trurit.

Ne sigurisht do të gjejmë mënyrat për të mos cenuar vijueshmërinë e aktivitetit tonë. Do të përipiqemi të përdorim më shumë outsourcing (shërbime nga të tretët), më shumë teknologji, etj., por, në periudhën afatshkurtër, do të kemi koston e moszhvillimit dhe mungesës së stabilitetit të burimeve njerëzore.

Vëmendja jonë më e madhe ka për të qenë në automatizim dhe eficiencë procesesh, për të kompensuar problemet në rritjen e produktivitetit që vijnë nga mungesa e burimeve njerëzore.

Ne si bankë do të vazhdojmë të kemi në fokus zhvillimin e produkteve dhe sjelljen e ofertave të reja në treg. Do të vijojmë me rritjen e dixhitalizimit të proceseve dhe synojmë të shtojmë më tej numrin e ATM-ve tona. Objektivat tanë janë gjithashtu të rrisim peshën e kartëmbajtësve dhe kartëpërdoruesve në strukturën e klientëve, si dhe më tej nivelin e transaksioneve bankare online. Kemi prezantuar kartën e studentit dhe synojmë të zgjerojmë produktet për brezin e ri. Jemi licencuar nga Visa, duke kompletuar ofertën tonë të kartave dhe brenda gjysmës së parë të vitit do të ofrojmë një produkt ekskluziv, Visa Platinum.

Sistemi ynë bazë është përditësuar, ndërsa vijojmë të kryejmë investime të mëdha në sigurinë kibernetike, duke garantuar një nivel sa më të lartë të sigurisë dhe mbrojtjes ndaj rreziqeve kibernetike.

Investimet tona në teknologjitë e identifikimit dhe nënshkrimin elektronik në distancë po rriten, duke mundësuar rritje të numrit të shërbimeve që klienti mund t'i marrë, pa qenë nevoja për t'u paraqitur në bankë. ■